

PËRSE PO NDALOHET DUHANI NË ANGLI?

Ligji i ri për ndalimin e pirjes së duhanit është duke hyrë në fuqi për të mbrojtur njerëzit nga pasojat e dëmshme të pirjes pasive.

Tymi i duhanit pasiv që hyn në organizmin tuaj përmban mbi 4,000 kimikate, mbi 50 e të cilave shkaktajnë kancer.

Ekspozimi për një kohë të gjatë mund të shtojë rrezikun që ju të merrni një sëmundje të rëndë përfshirë kancerin e mushkërive, sëmundje të zembrës ose atakun e astmës. Ai po kështu rrezikon që fëmijët të marrin sëmundje të rënda të rrugëve të frymëmarrjes si dhe sindromin e vdekjes së menjëhershme të foshnjave (SIDS).



NDIHMË PËR DUHANPIRËSIT QË DUAN TA LËNË DUHANIN

Rreth 70% e duhanpirësve thonë se duan ta lënë duhanin, dhe ligji i ri i ndalimit të pirjes së duhanit mund të jetë një shtysë e mëtejshme për ta bërë një gjë të tillë. Në rast se dëshironi të lini duhanin, NHS ju jep përkrahje të shkëlqyer dhe falas. Ajo përfshin:

- **Shërbime lokale të NHS-it për ndalimin e duhanit** – për të gjetur shërbimin tuaj lokal, telefononi falas Linjën e Ndhmës së NHS-it për Duhanin në 0800 169 0 169, vizitoni **gosomefree.co.uk**, dërgoni tekstin 'GIVEUP' si dhe kodin tuaj të plotë postar në numrin 88088 ose pyesni në klinikën e mjekut tuaj të familjes, farmaci ose spital.
- **Linja e Ndhmës e NHS-it për Duhanin** – mund të flisni me një punonjës të specializuar duke telefonuar 0800 169 0 169 (linjat hapen çdo ditë nga 0700 deri në 2300).
- **gosomefree.co.uk** – burim elektronik ku gjenden të gjitha këshillat, informatat dhe mbështetja që ju nevojitet që ta lini duhanin dhe të mos e filloni më.
- **Bashkë** – ky program mbështetjeje është falas, dhe synon t'ju ndihmojë të lini duhanin duke shfrytëzuar edhe kërkimet shkencore mjekësore edhe përvojën e ish-duhanpirësve. Keni mundësi të zgjidhni të merrni emaile, mesazhe me tekst, letra dhe telefonata. Për informata të mëtejshme telefononi Linjën e Ndhmës së NHS-sit për Duhanin në 0800 169 0 169 ose shkoni në **gosomefree.co.uk**

Për informata të mëtejshme lidhur me ligjin e ri të ndalimit të pirjes së duhanit në Angli ose për ta siguruar informacionin në formate të tjera, vizitoni faqen tonë elektronike: **smokefreeengland.co.uk** ose telefononi Linjën Informativë mbi Anglinë pa Duhan në **0800 169 169 7**.



SMOKEFREE

6000BV 03/07 DOH 280337

Albanian HM Government



NE ANGLI NDALOHET DUHANI MË 1 KORRIK 2007

Ja si do të ndikojë mbi ju ligji i ri për ndalimin e pirjes së duhanit.



SMOKEFREE

NHS

ANGLIA PA DUHAN

Që nga 1 korriku 2007 do të ndalohet duhani në të gjitha vendet e mbyllura publike dhe në vendet e punës.

Që nga ai moment, pirja e duhanit në këto vende do t'i takojë historisë – dhe do të jetë në kundërvajtje me ligjin.

Mendohet se ligji i ri do të ndihmojë shpëtimin e mijëra jetëve njerëzore gjatë dekadës së ardhshme, si dhe të krijojë objekte më të shëndetshme dhe të pastra argëtimi dhe pune.



Në vendet ku ka tabela të ndalimit të duhanit, është e jashtëligjshme të pihet duhan.

NË CILAT OBJEKTE DO TË NDALOHET DUHANI?

Ligji i ri mbi ndalimin e duhanit përfshin të gjitha objektet publike dhe të punës. Aty përfshihen pijetoret, klubet, baret, kafenetë, dyqanet, zyrat dhe fabrikat.

Nuk do të lejohen më dhomat ku punonjësit mund të pinë duhan, që do të thotë se ata që duan të pinë duhan duhet të dalin jashtë.

Gjithashtu, duhet të ndalohet duhani edhe në makinat e transportit publik dhe ato zyrtare, të cilat përdoren nga më shumë se një person në një moment të caktuar.



CILAT JANË DËNIMET?

Në vendet e tjera ku ndalohet duhani, si psh Irlanda, Skocia dhe Zelanda e Re, niveli i zbatimit është shumë i lartë, dhe ligjet janë bërë të vetë-detyrueshme me një shpejtësi të madhe.

Megjithëkëtë, çdokush që shkel ligjin e ri të ndalimit të duhanit bën vepër penale dhe mund të gjobitet deri me £200 për pirjen e duhanit në një vend të ndaluar.

Më poshtë paraqiten gjobat e përcaktuara dhe gjoba maksimale për secilën shkelje.

- Pirja e duhanit në vende apo makina ku është ndaluar:** personit që pi i vihet gjobë £50. Ose gjoba maksimale £200 në rast se procedohet penalisht dhe dënohet nga gjykata. (Gjoba fikse ulet në £30 në rast se paguhet brenda 15 ditëve.)
- Mos-vendosja e shenjave të ndalimit të duhanit:** gjobë £200 për këdo që është menaxher apo përdor objektet apo makinën ku ndalohet duhani. Ose gjoba maksimale £1000 në rast se procedohet penalisht dhe dënohet nga gjykata. (Gjoba fikse ulet në £150 në rast se paguhet brenda 15 ditëve.)
- Mos-parandalimi i pirjes së duhanit në një objekt ku ndalohet:** gjoba maksimale £2500 i jepet çdokujt që menaxhon ose kontrollon objektet ose makinat ku ndalohet pirja e duhanit në rastet kur procedohet penalisht dhe dënohet nga gjykata. Për këtë vepër penale nuk ka gjobë fikse.